



Komiteti për Komunitete
02. Nr. V
Deçan, dt. 10.05.2024

PROCESVERBAL

Mbledhja e pestë e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 10.05.2024.

Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u dhe Policia e Kosovës .

Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:
2. Raport nga ZLK-ja:
3. Raport nga Kryetari i Komunës së Deçanit për gjendjen e përgjithshme të komunitetit jo shumicë:
4. Raport nga Drejtoria e Qendrës për Punë Sociale në Deçan: për numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali, Egjiptianë, Malazez, Boshnjakë, Serbë dhe Rom.
5. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit..

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoj për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riadhesuar, ka pasur vizita neper vendbanimet ku gravitojnë më shumë komunitetet jo shumicë siç janë fshatrat Gramaçel dhe lagjen Pemishte.

Ku janë njoftuar për së afërmi me problemet që përballen ky komunitet që kryesisht kanë qenë probleme të infrastrukturës: ndriçim publik. Gjithashtu janë bërë vizita në dy shkolla ku gravitojnë më shumë nxënësit e komunitetit jo shumicë Ne Shkollën fillore "Rexhep Kadrijaj" në Rastavic dhe në Shkollën fillore "Drita" në Gramaçel. Nga Drejtoritë e shkollave të lartcekura u njoftuan se nxënësit e komuniteteve jo shumice janë të integruar plotësisht dhe nuk kanë asnjë problem sa i përket vijimit të shkollimit të rregullt.

III. Raport nga Kryetari i Komunës së Deçanit:

Sa i përket raportit nga Kryetari i Komunës së Deçanit: i pari i Komunës së Deçanit z; Bashkim Ramosaj i njoftoj te pranishmit me gjendjen e sigurisë në Komunën e Deçanit e cila paraqitet e shumë e mirë.

Regjistrimi i popullsisë është duke u bere në Komunën e Deçanit, proces që do të zgjas deri me datë 17.05.2024 dhe ftoj qytetaret ti përgjigjen sa më shume kësaj procedure që shkon në të mirë të tyre komunës dhe shtetit tonë.

Sa ju përket kërkesave te komunitetit jo shumice nuk dallojnë nga ato të pjesëtarëve të komunitetit shumicë e që kryesisht kanë të bëjnë me infrastrukture: rruge, ujësjellës kanalizim ndriçim etj.

Dëshira ime si kryetarë do te ishte që këto kërkesa te ishin për zhvillim punësim sepse mundësitë janë te mëdha fale resurseve natyrore qe i ka komuna e Deçanit, porse sfidë dhe problem kryesorë mbetet ndarja e buxhetit nga niveli qendror për komunën e Deçanit që është minimal dhe pamundëson shfrytëzimin e këtyre resurseve natyrore.

Si lajm te mire pas një kohe te gjatë e kemi fituar te drejtën shfrytëzimin të pronave me interes publik në Parkun Kombëtarë "Bjeshkët e Nemuna".

Znj, Elda Sharohoviç përfaqësuese e komunitetit Boshnjak i njoftoj te pranishmit se kanë filluar punimet ne asfaltimin dhe rregullimin e infrastrukturës ne fshatin Prapaqan gjegjësisht lagjen e komunitetit Boshnjak ne këtë fshat duke falënderuar kryetarin e komunës për këtë investim.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja kërkoj nga kryetari te dije se çfarë po bën komuna e Deçanit për problemin e braktisjes se shkollimit te rregullt fillor nga nxënësit dhe për rastin e një familje nga lagja Pemishte qe ka problem te natyrës ekonomike dhe banim.


Kryetari i Komunës tha se problematika e braktisjes se shkollimit te rregullt po vije si pasoj e lëvizjes së popullsisë gjegjësisht emigrimit të qytetarëve drejt shteteve të treta.

Sa i përket familjes në lagjen Pemishte komuna e Deçanit e ka ndihmuar disa here këtë familje porse problematika e kësaj familje tejkalon mundësitë dhe kapacitetet e komunës dhe do të duhej ti drejtohej nivelit qendror.


IV. Raport nga Drejtoria e Qendrës për Punë Sociale në Deçan: nga kjo drejtori u njoftuam se Drejtori ishte në pushim vjetorë dhe të njëjtit do i përsëritej ftesa për mbledhjen e ardhshme.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mbledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:
Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mbledhjes
Shkelzen Berisha





Komiteti për Komunitete
02. Nr. VI
Deçan, dt. 14.06.2024

PROCESVERBAL

Mbledhja e gjashte e rregullt e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 14.06.2024.
Në takim morën pjesë: anëtarët e Komitetit për Komunitete, OSBE, UNMIK-u.
Takimi u kryesua nga z. Shkelzen Berisha, i cili i përshëndeti të gjithë të pranishmit dhe i informoi për pikat e rendit të ditës të këtij takimi.

Për mbledhje ishin propozuar këto pika të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

2. Raport nga ZLK-ja:

3. Ftesë drejtorisë komunale për buxhet e financa të raportoje për Kornizën komunale buxhetore – Shqyrtimi i mundësisë për ndarjen e buxhetit për ndihmë të komuniteteve dhe planet rreth infrastrukturës neper vendet ku komunitetet jetojnë.

4. Raport nga Drejtoria e Qendrës për Punë Sociale në Deçan: për numrin e rasteve sociale nga komunitetet Ashkali, Egjiptianë, Malazez, Boshnjakë, Serbë dhe Rom.

5. Të ndryshme:

I. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Procesverbali miratohet një zëri pa asnjë vërejtje nga të gjithë anëtarët e Komitetit..

II. Raporti i ZLK-së:

Sa i përket raportit të ZLK-së: Shaban Pejçinović, Udhëheqës i ZLK-së, raportoje për punët e zyrës së Komitetit të Komuniteteve. Ai tha se zyra që udhëheq ai, gjatë këtij muaji nuk ka pasur ndonjë rast të personave të riatdhësuar, ka pasur një kërkesë nga familja Jollaj nga fshati Glllogjan për kyçe ne sistemin e kanalizimit, ku te njëjtëve ju është ndihmuar nga ZKK për hartimin e kësaj kërkesë dhe adresimin e saj tek zyra përkatëse.

III. Raport nga Drejtoresha për Buxhet dhe Financa Znj, Dafina Cacaj:

Sa i përket raportit Drejtoresha për Buxhet dhe Financa Znj, Dafina Cacaj: e njëjta i njoftoj te pranishmit se qarkorja e pare Buxhetore vetëm se ka mbërri dhe se janë ne fazën e

mblledhjes se informacioneve nga drejtoritë e ndryshme për nevojat e ndryshme buxhetore.

Drejtoresha i inkurajoj përfaqësuesit e komuniteteve jo shumice pranë Komitetit për Komunitete që të paraqesin kërkesa konkrete dhe se te njëjtat do te shqyrtohen.

Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja duke u nise nga përvoja paraprake e viteve te kaluara ku shumica e kërkesave te mblledhura ne terren nga anëtarët e Komitetit për komunitete nuk janë aprovuar: kërkoj nga Drejtoresha Znj, Dafina Cacaj qe këtë vit te merren para sysh.


Drejtoresha Znj, Dafina Cacaj tha se shumë projekte nga Komuniteti janë kryer si qeshte asfaltimi dhe kycja ne rrjetin e kanalizimit në lagjen Pemishte, Gramaçel dhe Prapaqan, projekte këto të bashkë financuara nga nivelin qendror me participim edhe nga Komuna e Deçanit.

IV. Raport nga Drejtoria e Qendrës për Punë Sociale në Deçan: nga kjo drejtori nuk ishte prezent askush.

V. Të ndryshme: Albesa Cacaj anëtare e Komitetit nga LDK-ja propozoj qe te mblidhen edhe një here të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete në Zyrën për Komitete dhe Kthim bashkërisht ti hartojnë kërkesat e komuniteteve ne një kërkesë dhe të njëjtat ti dorëzohen Drejtorisë për Buxhet dhe Financa dhe Komitetit për Politik dhe Financa.

Kryesuesi i falënderoi të pranishmit dhe shpalli mblledhjen të mbyllur.

Procesmbajtësi:
Artan Ismajlaj



Kryesuesi i mblledhjes
Shkelzen Berisha

